



**Republika e Kosovës**

***Republika Kosova – Republic of Kosovo***

***Qeveria – Vlada – Government***

2012-2017

STRATEGJIA KOMBËTARE E REPUBLIKËS  
SË KOSOVËS KUNDËR NARKOTIKËVE  
DHE PLANI I VEPRIMIT

Qershor 2012, Prishtinë

## PËRMBAJTJA

### SHKURTESAT

#### I. HYRJE

#### II. VIZIONI DHE MISIONI

#### III. METODOLOGJIA

#### IV. PARIMET E PËRGJITHSHME

4.1 Parimi i Kushtetutshmërisë dhe i Ligjshmërisë

4.2 Parimi i Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut

4.3 Parimet në Kujdesin Shëndetësor

4.4 Parimi i Garantimit të Sigurisë për të gjithë Qytetarët

4.5 Parimi i Vazhdimësisë

4.6 Parimi Gjithëpërfshirës

4.7 Parimi i Ndarjes së Përvojave, Përgjegjësive dhe Qasja e Përbashkët

4.8 Parimi për të Drejtën e Informimit

#### V. MEKANIZMAT LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

##### 5.1 Mekanizmat ligjor

5.1.1 Aktet ndërkombëtare të aplikueshme në Kosovë

##### 5.2 Mekanizmat Institucional

5.2.1 Koordinatori Nacional

5.2.2 Sekretariati i MPB-së

5.2.3 MPB - Policia e Republikës së Kosovës

5.2.4 Ministria e Ekonomisë dhe Financave - Doganat e Kosovës

5.2.5 Ministria e Drejtësisë

5.2.6 Këshilli Gjyqësor i Kosovës

5.2.7 Ministria e Shëndetësisë

5.2.8 Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

5.2.9 Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

5.2.10 Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

5.2.11 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

5.2.12 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

**5.2.13 Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit**

**VI. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME DHE SPECIFIKE**

**6.1 Reduktimi i Kërkesës dhe Zvogëlimi i Dëmit**

- 6.1.1 Parandalimi dhe Edukimi**
- 6.1.2 Trajtimi dhe Rehabilitimi**
- 6.1.3 Risocializimi dhe Ri-integrimi**
- 6.1.4 Zvogëlimin e dëmit**
- 6.1.5 Bashkëpunimi në reduktimin e kërkesës**

**6.2 Reduktimi i Ofertës dhe Furnizimit**

- 6.2.1 Parandalimi i Furnizimit dhe Ofertës**
- 6.2.2 Mbikëqyrja e Barnave Narkotike, Psikoaktive dhe Prekursorëve**
- 6.2.3 Hetimet (zbulimi) dhe Ndjekja**
- 6.2.4 Ndëshkimet (dënimet)**
- 6.2.5 Bashkëpunimi në Reduktimin e Ofertës dhe Furnizimit**

**6.3 Bashkëpunimi dhe Koordinimi**

- 6.3.1 Bashkëpunimi dhe Koordinimi Ndërinstitucional**
- 6.3.2 Bashkëpunimi dhe Koordinimi Ndërkombëtar**
- 6.3.3 Avancimi i Mëtejme i Kornizës Ligjore**

**6.4 Mekanizmat Mbështetës dhe Hulumtues**

- 6.4.1 Instituti i Mjekësisë Ligjore**
- 6.4.2 Agjencia e Kosovës për Forenzikë**
- 6.4.3 Laboratori i AKPM-së**
- 6.4.4 Hulumtimet**
- 6.4.5 Observatori Nacional për Droga**

**6.5 Mbikëqyrja dhe Monitorimi**

- 6.5.1 Mbikëqyrja e Zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit**
- 6.5.2 Monitorimi Periodik i Zbatimit të Aktiviteteve**
- 6.5.3 Evaluimi**
- 6.5.4 Komisioni për Vlerësimin e Strategjisë**
- 6.5.5 Informimi (publikimi i rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit)**

## II. SHKURTESAT

ZKM	Zyra e Kryeministrit
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MD	Ministria e Drejtësisë
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
AKI	Agjencia e Kosovës për Inteligjencë
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë, dhe Sportit
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MIE	Ministria e Integriteteve Evropiane
<b>QIF</b>	<b>Qendra e Inteligjencës Financiare</b>
PK	Policia e Kosovës
DK	Dogana e Kosovës
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
IGJK	Instituti Gjyqësor i Kosovës
KP	Këshilli Prokurorial
SHK	Shërbimi Korrektues
SHS	Shërbimi Sprovues
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë
ICITAP	Programi për Ndihmë Ndërkombëtare dhe Trajnime për Hetime të Krimin
KFOR	Forcat Ushtarake të Sigurisë Ndërkombëtare në Kosovë
KE	Këshilli i Evropës
<u>IEK</u>	Informim, Edukim, Komunikim
OJQ	Organizata Joqeveritare
DIFID	Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtarë i Britanisë së Madhe
Peer to Peer	Të njëjtë për të njëjtë

<b>Outreach</b>	<b>Aktivitetet që zhvillohen në terren jashtë selisë së Organizatës apo Institucionit</b>
<b>BQK</b>	<b>Banka Qendrore e Kosovës</b>
<b>ISH</b>	<b>Institucionet Shëndetësore</b>
<b>KNKD</b>	<b>Koordinatori Nacional Kundër drogave</b>
<b>SECI Center</b>	<b>Iniciativa e Evropës Juglindore për Kooperim</b>
<b>UNDOC</b>	<b>Zyra e Kombeve të Bashkuara për Droga dhe kriminalitet</b>
<b>IBZ</b>	<b>Instituti i Bazelit Zvicër</b>
<b>EMCDDA</b>	<b>Qendra Evropiane për Monitorimin e Përdorimit të Drogave</b>
<b>AKPM</b>	<b>Agjencia Kosovare për Produkte Medicinale</b>
<b>KE</b>	<b>Komisioni Evropian</b>

## I .HYRJE

Republika e Kosovës gjegjësisht Qeveria duke qenë e vetëdijshme për dukurinë e drogave si një dukuri ndërkombëtare e cila në mënyrë direkte dhe indirekte paraqet rrezik për vendin tonë harton dhe miraton Strategjinë e dytë Nacionale kundër Drogave.

Me këtë Strategji Nacionale Qeveria e Kosovës obligon institucionet përgjegjëse të vendit për të ndërmarrë veprime konkrete në fushën e parandalimit dhe luftimit të kësaj dukurie negative dhe të rrezikshme për vendin tonë dhe njëkohësisht nxit dhe përkrah OJQ-të për të dhënë kontributin e tyre. Duke qenë se Kosova si pozitë gjeostrategjike gjendet në pjesën qendrore të Gadishullit Ballkanik, e ndërlidhur me shtetet e rajonit vazhdimisht ka tendenca të atakimit nga kjo dukuri qoftë në përdorimin e drogave po ashtu në trafikimin brenda apo përmes territorit tonë.

Qeveria e Republikës së Kosovës, është duke bërë përpjekje që të përmirësojë situatën aktuale përmes parandalimit dhe luftimit të kësaj dukurie me qëllim të progresit drejt rrugës së integriteteve euro-atlantike, njëkohësisht shpreh vullnetin për të bashkëpunuar me të gjitha shtetet dhe mekanizmat tjerë ndërkombëtar për të minimizuar pasojat nga drogat.

Veprimet të cilat do të ndërmerren nga institucionet vendore të parapara me këtë strategji janë të orientuara dhe të ndërlidhura në reduktimin e kërkesës dhe ofertës me qëllim minimizimin e dëmeve nga dukuria e drogave. Këto veprime sipas kësaj strategjie dhe planit të veprimit obligojnë institucionet shtetërore në marrjen e përgjegjësisë dhe detyrave sipas fushave përkatëse, dhe këto të jenë të koordinuara nga MPB-ja si përgjegjëse e hartimit dhe implementimit të kësaj strategjie.

Strategjia Kombëtare Kundër Drogave 2012-2017 është e mbështetur në Kushtetutën dhe legjislacionin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës, instrumentet ligjore ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Në kuptimin gjithëpërfshirës, drogat paraqesin materie psiko-aktive, të cilat po qe se përdoren nga ana e personit kanë aftësi që të ndryshojnë dhe dëmtojnë seriozisht integritetin psiko-fizik të personit i cili i përdor, gjegjësisht i keqpërdorë ato.

Keqpërdorimi me droga është problem i madh shoqëror dhe shëndetësor në mbarë botën, ngase pasojat që dalin nga efektet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta nga kjo dukuri janë

shumëfish të dëmshme për vetë personin, familjen dhe shoqërinë në tërësi si dhe ndikon në rrezikimin e sigurisë shtetërore.

Keqpërdorimi i drogave në shoqëri gjithashtu ndikon në rritjen e të gjitha formave të kriminalitetit.

Strategjia kombëtare kundër drogave në Republikën e Kosovës për periudhën 2012-2017 është hartuar duke u mbështetur në Kushtetutën, legjislacionin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës, instrumentet ligjore ndërkombëtare si dhe raporteve tjera vendore ( raporteve vjetore nga agjencitë e zbatimit të ligjit, institucionet edukativo-shëndetësore, raportet hulumtuese të organizatave të ndryshme qeveritare dhe jo qeveritare, raporti i vlerësimit të strategjisë kundër drogave) analiza e situatës lidhur me problematikën e kësaj dukurie.

Kjo strategji është e strukturuar në mënyrë të tillë që të identifikoj qartë qëllimet dhe objektivat për të parandaluar dhe luftuar trafikimin e drogave dhe substancave tjera narkotike.

Strategjia kombëtare kundër drogave ka për qëllim të ndihmojë zhvillimin dhe implementimin e politikave duke forcuar kapacitetet institucionale kundër drogave në të gjitha nivelet.

## **II. VIZIONI DHE MISIONI**

### **Vizioni**

Vizion i kësaj strategjie është ruajtja e shëndetit të popullatës në Kosovë dhe mbrojtja nga kërcënimet e përdorimit dhe keqpërdorimit të drogave.

### **Misioni**

Misioni i kësaj strategjie është të përcaktoj objektivat e përgjithshme, objektivat specifike dhe aktivitetet me qëllim që të parandalojë, luftojë si dhe të harmonizoj veprimet ndërinstucionale vendore dhe ndërkombëtare për arritjen e objektivave të përcaktuara.

## **III. METODOLOGJIA**

Strategjia kombëtare kundër drogave bazohet në parimet që burojnë nga Kushtetuta e Kosovës, legjislacioni i aplikueshëm, instrumentet ligjore ndërkombëtare si dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Problemit të drogave në shoqërinë kosovare duhet kushtuar kujdes dhe përgjegjësi nga institucionet kombëtare dhe shoqëria civile në përgjithësi. Të gjithë mekanizmat duhet të angazhohen në parandalimin dhe zbulimin e keqpërdorimit të drogave dhe krimit të organizuar për te evituar rrezikun që paraqet kjo në aspektin kombëtar dhe ndërkombëtar.

Për të pasur sukses dhe rezultat në këtë fushë nevojitet kohë dhe përvojë e institucioneve dhe shoqërisë në përgjithësi.

Qëllimi i kësaj strategjie është zhvillimi i politikave për marrjen e përgjegjësive për mbrojtjen e individit dhe shoqërisë, dhe problemet që janë pasojë e keqpërdorimit të drogave.

Ngritja e vetëdijes së individit dhe shoqërisë në përgjithësi e cila mundëson marrjen e vendimeve dhe përgjegjësive lidhur me keqpërdorimin e drogave.

Angazhimi i të gjitha institucioneve për të parandaluar dhe luftuar dukurinë e drogave me veprime sistematike dhe të koordinuara mirë me qëllim shkatërrimin e rrjeteve të shpërndarjes dhe tregtimit të drogave në të gjitha nivelet.



Për te rritur bashkëpunimin ndërsektorial brenda vendit dhe bashkëpunimin ndërkombëtar me të gjitha shtetet dhe agjencitë që kanë përgjegjësi në fushën e dukurisë së drogave duhet që ky bashkëpunim të jetë i koordinuar mirë në institucionet dhe mekanizmat shtetëror.

Hartimi i dytë i kësaj strategjie, orientohet në përcaktimin e objektivave të përgjithshme, atyre specifike si dhe veprimet e planifikuara që cojnë drejt suksesit për parandalim, luftim dhe përgatitjen e kuadrit profesional në të gjitha institucionet me veprime të përbashkëta të të gjithëve që do të ndërmerren në pese vitet e ardhshme (2012-2017).

Me anë të kësaj strategjie përveç obligimit të institucioneve përkatëse shprehet vullneti dhe gatishmëria për të përkrahur projektet vendore dhe ndërkombëtare për të trajtuar problematikën e dukurisë së drogave në mënyre profesionale në tri fushë veprimtaritë: reduktimin e kërkesës, ofertës dhe koordinimit ndër-sektorial si dhe të kryhen hulumtime dhe mbledhje të të dhënave.

Formohen mekanizma implementues, mbikëqyrës, raportues, vlerësues, hulumtues dhe koordinues në kuadër të kësaj strategjie.

Objektivat e parapara në Strategjinë Kombëtare Kundër Drogave dhe në Planin e Veprimit udhëhiqen nga parimet vijuese:

## **IV. PARIMET E PERGJITHSHME**

### **4.1 Parimi i Kushtetutshmërisë dhe i Ligjshmërisë**

Veprimet e ndërmarra për luftimin e drogës duhet të bazohen në dispozitat e parapara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, legjislacionin në fuqi si dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

### **4.2 Parimi i Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut**

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton liritë dhe të drejtat e të gjithë individëve , gjatë të gjitha fazave të angazhimit të institucioneve në luftën dhe parandalimin e drogave të drejtën e të gjithë qytetarëve të Kosovës pavarësisht përkatësisë etnike, gjinisë, moshës, religjionit, dhe në veçanti të drejtat e fëmijëve dhe grave.

Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtë të jetojnë në një ambient i cili është i mbrojtur nga përdorimi dhe keqpërdorimi i drogave.

Qytetarët, përfshirë edhe përdoruesit e drogave kanë të drejtë në përkujdesje sociale, shëndetësore dhe mbrojtje nga përjashtimi shoqëror.

Parimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut përfshinë gjithashtu trajtimin e drejtë gjatë procesit hetimor, procedurës gjyqësore si dhe fazës së ekzekutimit të sanksioneve.

### **4.3 Parimi në Kujdesin Shëndetësor**

Parandalimi i përdorimit, trajtimi dhe rehabilitimi i personave që kanë krijuar vartësi bazohet në parimet e kujdesit shëndetësor të përcaktuara edhe në Ligjin e Shëndetësisë së Kosovës, udhërrëfyesit dhe protokollat që zbatohen në shërbimin shëndetësor të Kosovës.

### **4.4 Parimi i Garantimit të Sigurisë për të gjithë Qytetarët**

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton të drejtën për siguri dhe mbrojtje për të gjithë qytetarët. Ky parim i referohet edhe zvogëlimit të krimeve që ndërlidhen me keqpërdorimin e drogave.

### **4.5 Parimi i Vazhdimësisë**

Për luftimin e kësaj dukurie kërkohet angazhim i vazhdueshëm dhe gjithëpërfshirës i të gjitha institucioneve dhe akterëve të ndryshëm. Aktivitetet në luftën kundër drogave duhet të shihen si pjesë e një strategjie të vazhdueshme.

#### **4.6 Parimi Gjithëpërfshirës**

Keqpërdorimi i drogave në shoqërinë e sotme është një dukuri e përgjithshme me të cilën përballen të gjitha shtetet e botës. Kjo problematikë bartet dhe ndikon në të gjitha nivelet e shoqërisë duke përfshirë komunitetin lokal, grupet, familjen dhe individin.

Parimi i gjithëpërfshirës nënkupton përfshirjen e të gjitha institucioneve, mekanizmave tjerë si dhe shoqërinë në përgjithësi në trajtimin e kësaj dukurie në nivel shtetëror dhe ndërkombëtar.

#### **4.7 Parimi i Ndarjes së Përvojave, Përgjegjësive dhe Qasja e Përbashkët**

Me këtë parim nënkuptohet ndarja e përvojave dhe praktikave më të mira, ndarja e përgjegjësive në të gjitha nivelet si dhe qasja e përbashkët e të gjithë aktereve në luftë kundër drogave.

#### **4.8 Parimi për të Drejtën e Informimit**

Ky parim nënkupton të drejtën dhe obligimin për t'i informuar qytetarët e Republikës së Kosovës për rreziqet dhe pasojat e përdorimit të drogave dhe mundësinë për trajtimin dhe rehabilitimin e vartësve nga drogave.

## V. MEKANIZMAT LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

### 5.1 Mekanizmat ligjor

Në luftë kundër drogës, Republika e Kosovës ka në fuqi një bazë të gjerë legislative, ku si legjislacioni parësor mund të përmendën por nuk kufizohen vetëm në:

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës
2. Kodi Penal i Kosovës
3. Kodi i Procedurës Penale të Kosovës
4. Ligji nr. 02/L-128 për Barnat Narkotike, substanca Psikotrope dhe Prekursorë
5. Ligji për agjencinë e Kosovës për inteligjencë
6. Ligji për Gjykatat
7. Ligji nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit
8. Ligji nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës
9. Ligji nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës
10. Ligji nr. 03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës
11. Ligji nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.
12. Ligji nr. 04/L-076 për Policinë
13. Ligji nr. 04/L-015 për mbrojtjen e Dëshmitarëve
14. Ligji nr. 04/L-043 për mbrojtjen e Informatorëve
15. Kodi Drejtësisë për të Mitur
16. Kodi doganor dhe i akcizave
17. Ligji nr. 03/L-191 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale
18. Ligji nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare
19. Ligji nr. 03/L-137 për Departamentin e Mjekësisë Ligjore.
20. Ligji nr. 03/L-142 për Rendin dhe Qetësinë Publike
21. Ligji nr. 03/L-097 për Masat Antidamping dhe Masat Kundërbalancuese
22. Ligji nr. 03/L-187 për Mjekësinë Ligjore
23. Ligji nr. 03/L-196 për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit
24. Ligji nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës
25. Ligji nr. 04/L-030 për Përgjegjësinë e Personave Juridik për Vepra Penale
26. Ligji nr. 04/L-31 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale
27. Ligji nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës

28. Ligji nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare
29. Ligji nr. 04/L-078 për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve
30. Ligji nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror
31. Ligji nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas
32. Ligji nr. 04/L-093 për Bankat Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare
33. Ligji nr. 02/L-50 për Kujdesin Shëndetësor Emergjent
34. Ligji nr. 02/L-38 për Inspektoratin Shëndetësor
35. Ligji nr. 2004/50 për Veprimtarinë Private në Shëndetësi
36. Ligji për mbrojtjen sociale
37. Ligji nr. 02/L-57 për Institucionet e Kulturës
38. Ligji nr. 2004/38 për të Drejtat e përgjegjësitë e qytetarëve në sistemin shëndetësor
39. Ligji nr. 2004/4 për Shëndetësi
40. Ligji për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse
41. Ligji nr. 03/L-124 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shëndetësi
42. Ligji nr. 02/L-30 për Mbeturina
43. Ligji nr. 02/L-76 për Shëndetin Riprodhues
44. Ligji nr. 02/L-101 për Transfuzionin e Gjakut, Kontrollin e Gjakut dhe Produkteve të tij

#### **5.1.1 Aktet ndërkombëtare të aplikueshme në Republikën e Kosovës:**

1. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut,
2. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive themelore të Njeriut dhe Protokollat e saj.
3. Konventa për të Drejtat e fëmijëve
4. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollat e saj.
5. Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.

#### **Kjo strategji është po ashtu në përputhje me aktet ndërkombëtare që rregullojnë fushën e luftimit të krimit të organizuar dhe fushën e parandalimit dhe luftimit të drogave:**

1. Protokollin që amendon Marrëveshjet, Konventat dhe Protokollat mbi Drogat narkotike, përfunduar në Hagë më 23 janar 1912, Gjenevë më 11 Shkurt 1925 dhe 19 Shkurt 1925 dhe 13 korrik 1931, në Bangkok më 27 nëntor 1931 dhe në Gjenevë më 26 qershor 1936. Lake Success,

New York, 11 dhjetor 1946. Data e hyrjes në fuqi të Konventës: 11.12.1946, zëvendësuar nga Konventa e Vetme për Drogat Narkotike e 1961.

2. Konventa Ndërkombëtare e Opiumit, bërë në Hagë më 23 janar 1912. Data e hyrjes në fuqi të Konventës: Zëvendësuar nga Konventa e Vetme për Drogat Narkotike e 1961.

3. Konventa për kufizimin e prodhimit dhe rregullimin e shpërndarjes së Drogave Narkotike, bërë në Gjenevë, më 13 korrik 1931 dhe Lake Success, New York, 11 dhjetorë 1946. Data e hyrjes në fuqi të Konventës: 21.11.1947-Zëvendësuar nga Konventa E Vetme për Drogat Narkotike e 1961.

4. Konventa për kufizimin e prodhimit dhe rregullimin e shpërndarjes së Drogave Narkotike, bërë në Gjenevë, më 13 korrik 1931 dhe Protokolli i nënshkrimit

5. Protokolli që sjell në kontrollim drogat jashtë qëllimit të Konventës së 13 korrikut 1931 për kufizimin e prodhimit dhe rregullimin e shpërndarjes së Drogave Narkotike, bërë në Gjenevë, më 13 korrik 1931 dhe Lake Success, New York, 11 dhjetor 1946, bërë në Paris më 19 nëntor 1948.

6. Konventa për substancat psikotrope, bërë në Vjenë më 21 Shkurt 1971. Data e hyrjes në fuqi të Konventës: 16.08.1971.

7. Konventa e vetme mbi Drogat narkotike, 1961, e ndryshuar nga Protokolli që ndryshon Konventën e vetme mbi Drogat Narkotike, 1961, bërë në New York, më 08.08.1975.

8. Konventa e Kombeve të bashkuara kundër Trafikut të paligjshëm të Drogave narkotike dhe Substancave Psikotrope, bërë në Vjenë, më 20 Dhjetor 1988.

## **5.2 Mekanizmat Institucional**

Mekanizmi institucional nënkupton rolin dhe koordinimin e aktiviteteve të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë dhe institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës të cilat kanë rol në parandalimin dhe luftimin e trafikimit me droga dhe keqpërdorimit të prekursorëve.

### **5.2.1 Koordinatori Nacional**

Koordinatori Nacional është personi përgjegjës mandati i të cilit është të koordinojë, bashkërendojë, monitorojë dhe të raportojë për implementimin e politikave, aktiviteteve dhe veprimeve lidhur me drogat.

### **5.2.2 Sekretariati i MPB-së**

Është organ i ri, roli i të cilit është mbledhja e informacioneve dhe të dhënave nga institucionet tjera me qëllim të analizimit dhe vlerësimit të atyre informatave si dhe përgatitja e raporteve analitike për Koordinatorin Nacional.

### **5.2.3 MPB - Policia e Republikës së Kosovës**

MPB ka rol funksional në arritjen e objektivave të caktuara në këtë strategji. Policia e Kosovës si Agjencia për zbatimin e ligjit në kuadër të MPB-së, ka përgjegjësinë e plotë në luftimin kundër përdorimit, blerjes, posedimit, shitjes, shpërndarjes, importimit, eksportimit, përpunimit, kultivimit, dhe përgatitjes së substancave ose preparateve që janë të shpallura të rrezikshme si droga.

**Policia e Kosovës**, bashkarisht me Doganën e Kosovës, janë Institucionet e para të luftimit të aktiviteteve të paligjshme për arsye të rolit të tyre në ruajtjen e kufirit të Kosovës dhe parandalimit të lëvizjeve të tregtimit të paligjshëm. Prandaj, bashkëpunimi dhe koordinimi i tyre është faktori kyç i përforcimit të kontrollit të aktiviteteve të paligjshme të cilat do të dëmtonin shëndetin publik dhe sigurinë e Kosovës.

### **5.2.4 Ministria e Ekonomisë dhe Financave - Doganat e Kosovës**

**Dogana e Kosovës** si agjenci e zbatimit të ligjit në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, ka rol në kontrollimin e të gjitha mallrave që hyjnë dhe dalin nga Kosova.

Dogana e Kosovës për shkak të prezencës kapilare në të gjithë territorin e Kosovës dhe rolit funksional të saj në kontrollimin e mallrave në Kufi është institucion i rëndësishëm e cila bashkë me Policinë e Kosovës bën kontrollimin dhe identifikimin e tregtive dhe transporteve të paligjshme.

Strategjia Shtetërore e Menaxhimit të Integruar të Kufirit dhe Plani Veprues, duhet të përcillet me qëllim të përforcimit të bashkëpunimit dhe koordinimit të dy organeve kryesore që luftojnë përdorimin, tregtinë, transportin dhe prodhimin e drogave të paligjshme.

### **5.2.5 Ministria e Drejtësisë**

1. Ministria e Drejtësisë përgatit dhe zhvillon legjislacionin në fushën e drejtësisë;
2. Koordinon dhe zhvillon bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet penale;
3. Do të funksionalizoj me kapacitet të plota agjencinë për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose konfiskuar, për menaxhim efikas të sendeve të konfiskuar.

4. Angazhohet në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe teknike të shërbimit korrektues për të luftuar të gjitha dukurit negative në burgje duke përfshirë luftën kundër narkotikëve me qëllim të krijimit të një ambienti të sigurt për personat e burgosur.
5. Përmes shërbimit sprovues mbikëqyr ndihmon kryerësit me dënime alternative dhe të varurit nga droga të cilit i nënshtrohen trajtimit të detyrueshëm rehabilitues që zbatohet në liri.

#### **5.2.6 Këshilli Gjyqësor i Kosovës**

Siguron që gjykatat në Republikën e Kosovës do të jenë të pavarura, profesionale si dhe të pa anshme. KGJK-po ashtu është kompetent edhe për inspektimin dhe administrimin e gjykatave.

**Gjykatat-** Sigurohen që të gjykojnë çështjet penale ndaj personave të akuzuar që merren me trafikim. Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të identifikoj gjyqtarët për specializimin e tyre me qëllim të gjykimit të rasteve lidhur me trafikim. Gjykatat do të inkurajohen nga KGJK-ja që çështjet penale të kësaj natyre të zgjidhen me prioritet si dhe të unifikojnë politikën e dënimeve.

#### **5.2.7 Ministria e Shëndetësisë**

Ministria e Shëndetësisë merr pjesë në parandalimin, trajtimin, rehabilitimin mjekësor të individëve. Këtë e realizon përmes akteve ligjore, strategjive, planeve përkatëse, protokolleve klinike, trajnimeve dhe sigurimit të materialit dhe medikamenteve.

Ministria e Shëndetësisë përmes AKPM-së bënë regjistrimin e operatorëve me narkotik dhe prekursor si dhe mbikëqyrë prodhimin, importin, exportin, transitin, deponimin, distribuimin dhe dispenzimin e barnave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve.

Këto aktivitete i realizon përmes institucioneve shëndetësore dhe punëtoreve të angazhuar në to duke vepruar brenda institucioneve dhe në komunitet.

Brenda sistemit të informimit shëndetësor duhet të vendoset edhe baza e re e të dhënave dhe raportimi i drejtpërdrejt sekretariatit për të dhënat statistikore me të cilat disponon për përdoruesit e drogës.

**Instituti i Shëndetit Publik** -zhvillon dhe organizon hulumtime shkencore lidhur me trendët e përdorimit të drogave, krijon data-bazën unike dhe i mbledh të dhënat nga institucionet publike dhe private për personat të cilët janë të varur nga konsumimi i drogave.

**Qendrat Emergjente Spitalore dhe Klinikat neuropsikiatrike** e bëjnë pranimin e personave të cilët kërkojnë ndihmë shkakut i problemeve shëndetësore të shkaktuara nga përdorimi i



substancave narkotike (mbidozimi dhe përdorimi i prekursorve<sup>1</sup>). Këto Qendra i regjistrojnë të dhënat në formularë unik për të gjitha Qendrat (QKUK, Qendrat Emergjente Rajonale dhe Komunale) dhe e bëjnë informimin e Institucioneve përgjegjëse (Policinë e Kosovës, ISHPK, Klinikat etj) për rastet të cilat kanë të bëjnë me substancat narkotike.

#### **5.2.8 Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale**

Roli i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale është të mbajë evidencën e personave që janë të varur nga droga dhe janë shfrytëzues të ndihmave sociale. Të hartojë plane dhe programe për mbrojtjen e familjes, individit në atë mënyrë që të japë përkrahje sociale si dhe bashkëpunon me institucione tjera për identifikimin, këshillimin dhe trajtimin e mëtutjeshëm të përdoruesve të drogave.

#### **5.2.9 Ministria e Tregtisë dhe Industrisë**

Roli i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë është që në bashkëpunim me Agjencionin Kosovar për Produkte Medicinale të përcaktojë kushtet dhe procedurat e operimit me prekursorë të cilët kanë përdorim në industri dhe bëjnë mbikëqyrjen e operimit me prekursorë.

#### **5.2.10 Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**

Roli i Ministrisë së Bujqësisë është të bëj identifikimin e drogës për qëllime veterinarë.

#### **5.2.11 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**

Roli i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është të bashkëpunoj me MSH, MD, MPB, Prokurorisë dhe Gjykatave për hartimin e procedurave për deponimin, asgjësimin e drogave dhe prekursorëve të konfiskuar.

#### **5.2.12 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë**

Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë merr pjesë në parandalimin e drogave, përmes programeve të rregullta, duke i realizuar objektivat e shëndetit publik nëpërmjet aktiviteteve shkollore dhe jashtë shkollore, në të cilat aktivitete mund të kyçen prindërit dhe komuniteti në përgjithësi.

#### **5.2.13 Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit**

Roli i MKRS është të bashkëpunoj me MSH, MASHT, MPB dhe Policinë lidhur me hartimin e programeve edukative jashtë kurrikulare, të cilat promovojnë mënyrën e shëndoshe të jetës.

---

<sup>1</sup> Prekursorët janë substance natyrore ose sintetike të cilat mund të përdoren për përfitimin e drogave

## Struktura Organizative e Mekanizmit Koordinues, Monitorues dhe Implementues

REDUKTIMI I KËEKESËS DHE ZVOGËLIMI I DËMIT	REDUKTIMI I OFERTËS DHE FURNIZIMIT	BASHKËPUNIMI DHE KOORDINIMI	MEKANIZMAT MBËSHTETËS	MBIKQYRJA DHE MONITORIMI
MASHT, MPB, MSH, MKRS, PK, ISHP, MPMS, OJQ-të, Klinika Psikia.	Koordinator Nacional, PK, Doganat, AKPM, Inspektorati i Shëndetësisë, Inspektorati farmaceutik, AKI-ja, Shërbimi Korrektues, Prokuroria, Gjykata, KGJK, KPK, AMA, QIF,	MPB, IKPSHK, PK, DK, QIF, SHK, AKI, MSH, MASHT, MRKS, OJQ-të, AKPM, ISH, IF, MD, AMA, MPMS	Qeveria e Kosovës MPB, MD, IML, AKF, AKF, AKF, Lab. i AKPM-së PK, Observatori, IMJ,	Koordinator Nacional, Sekretariati i MPB-së,

## **VI. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME DHE SPECIFIKE**

### **6.1 Reduktimi i Kërkesës dhe Zvogëlimi i Dëmit**

Reduktimi i kërkesës përfshinë ndërmarrjen e një sërë veprimesh, masash dhe aktiviteteve të veçanta nga secili institucion përgjegjës dhe ato të përbashkëta të të gjitha aktereve, të ndërlidhura dhe të koordinuara të cilat kanë për qëllim parandalimin e përdorimit të drogave, zvogëlimin e numrit të personave që përdorin drogën dhe arritjen e vetëdijes përmes edukimit për pasojat që sjell keqpërdorimi i drogës për shoqërinë.

Reduktimi i kërkesës gjithashtu përfshinë veprimet konkrete dhe që ndërmerren për trajtim dhe rehabilitim vullnetar ose të obligueshëm për personat që janë të varur nga drogat me qëllim zvogëlimin e dëmeve.

Reduktimi i kërkesës po ashtu përfshinë një numër masash komplekse për risocializimin dhe ri-integrimin e personave të cilët kanë pasur sukses gjatë fazave të ndryshme të trajtimit dhe rehabilitimit.

Të gjitha veprimet e reduktimit të kërkesës koordinohen duke përdorur efektet synergjike dhe bashkërenduese të të gjitha institucioneve dhe mekanizmave tjerë të përfshirë në këtë fushë me qëllim të arritjes së objektivave të parapara nga kjo strategji dhe plan i veprimit.

#### **Objektivat specifikë të reduktimit të kërkesës janë:**

- 6.1.1 Parandalimi dhe Edukimi
- 6.1.2 Trajtimi dhe Rehabilitimi
- 6.1.3 Risocializimit dhe Ri-integrimit
- 6.1.4 Zvogëlimi i dëmit
- 6.1.5 Bashkëpunimi në reduktimin e kërkesës

#### **6.1.1 Parandalimi dhe Edukimi**

Parandalimi i përdorimit të drogave nënkupton një sërë veprimesh ndërsektoriale të mekanizmave të parapara me këtë strategji të cilat sigurojnë dhe promovojnë jetën e shëndoshë, rrisin vetëdijen përmes edukimit permanent . Kjo arrihet përmes veprimeve të nduarnduarshme dhe sistematike të të gjitha aktereve duke filluar nga familja, rrethi shoqërorë, shkollat, institucionet lokale dhe qendrore, shoqëria civile etj.

Me këtë sigurohet ngritja e vetëdijes së individit dhe shoqërisë për rrezikun që paraqet droga.

Njëkohësisht bazuar në njohuritë e fituara bëhet edhe mobilizimi i komunitetit duke ndërmarr masat efektive kundër përdorimit të drogave.

Masat kryesore për parandalim dhe edukim mund të jenë të përgjithshme ose selektive të përcaktuara varësisht nga ajo se kujt i dedikohen dhe nga cilat institucione zbatohen, (grupet e caktuara, institucionet parashkollore, shkollat, familja dhe shoqëria).

#### **a) Familja**

Është i nevojshëm vetëdijesimi i prindërve për një komunikim më të mirë me fëmijët në momentet e krijimit të personalitetit si dhe krijimin e kushteve për rritjen e fëmijëve, informimin dhe marrjen e vendimeve të përshtatshme.

Vetëdijesimi i prindërve dhe kujdestarëve është parakushti kryesor për parandalimin e fillimit të përdorimit të drogave dhe edukimin familjar mbi pasojat e përdorimit të drogave.

#### **b) Institucionet shkollore**

Pjesëmarrja aktive e mësuesve, pedagogëve në të gjitha institucionet shkollore duke filluar nga nivelet e ulëta deri tek ato universitare qoftë publike apo private për të parandaluar përdorimin e drogave me programe të ndryshme edukative, shëndetësore të inkuorporuar në kurikulat e rregullta mësimore si dhe aktivitete ekstra kurikulare të informimit që kanë karakter edukativ të përshtatshëm të adaptuara për mosha dhe nivele kulturore të fëmijëve dhe ambientet ku zbatohen këto programe. Në ambientet shkollore po ashtu duhet të arrihet siguria fizike e pjesëmarrësve në aktivitet (arsimtarëve, nxënësve).

#### **c) Komuniteti**

Komuniteti luan rol të rëndësishëm si shtytës në mobilizimin dhe pjesëmarrjen aktive të të gjithë qytetarëve për parandalimin dhe krijimin e kushteve më të favorshme për pjesëtarët e tij duke bashkëpunuar me të gjithë mekanizmat lokal të të gjitha fushave (sigurisë, bizneseve, humanitare, edukativo-shëndetësore, OJQ etj). Këtë e realizon përmes bashkëveprimit multisektorial (institucionet përgjegjëse në fushën e punëve të brendshme, gjyqësisë, shëndetësisë, mbrojtjes sociale dhe organizatave joqeveritare) për zbatimin e programeve parandaluese dhe vetëdijësuese për qytetarët.

### **6.1.2 Trajtimi dhe Rehabilitimi.**

Për të arritur sukses në trajtimin dhe rehabilitimin e personave të varur nga drogat duhet zhvilluar programe shëndetësore të avancuara sipas standardeve dhe praktikave më të mira

ndërkombëtare. Individëve duhet t'u ofrohen informata të duhura rreth procesit të trajtimit dhe rehabilitimit në të gjitha fazat e programeve dhe të shikohet mundësia e dhënies së kontributit nga ana e tyre.

Identifikimi sa më i hershëm i individëve të cilët përdorin droga mund të sjell deri te shansi më i mirë për fillimin e intervenimeve të trajtimit me kohë të tyre, duke zvogëluar rrezikun për të kaluar në përdorues të rregullt. Duhet të krijohen programe moderne të trajtimit të bazuara në metodat farmakologjike , toksikologjike , psikoterapeutike , socioterapeutike për nevojat individuale të secilit pacient. Këto programe duhet të jenë të bazuara në programe detoksikuese dhe programe mbajtëse apo zëvendësuese.

Trajtimi duhet të bëhet në mënyrë të organizuar unike, të vazhdueshme bazuar në parimet e shërbimit shëndetësor në kuadër të sistemit të mbrojtjes shëndetësore duke u bazuar në legjislacionin vendor sipas standardeve dhe normave ndërkombëtare të përcaktuara. Në kuadër të kësaj duhet të krijohen programe për zvogëlimin e dëmit.

### **6.1.3 Risocializimi dhe Ri-integrimi**

Zbulimi i hershëm nënkupton marrjen e masave, stimulimin dhe motivimin e personave që kanë filluar të përdorin drogën, të ndërpresin këtë në mënyrë që të mund të fillohet me trajtimin e tyre (shërimin). Personave të cilët kalojnë me sukses programet e trajtimit dhe rehabilitimit institucionet publike dhe komuniteti duhet t'u ndihmohet me të gjitha mjetet në dispozicion me qëllim që t'u ofrohet mbështetje psiko-sociale.

Ç'do masë për zbulimin e hershëm të përdoruesve të drogës parandalon dëmtimin e mëtejshëm të shëndetit të tyre sidomos të ndërlidhura me sëmundje ngjitëse si: Hepatiti B , C dhe HIV infeksioni.

Ri-integrimi nënkupton një numër masash dhe aktiviteteve me të cilin personat që kanë krijuar varësi nga droga, duhet t'u ndihmohet në rehabilitim, integrim dhe mos diskriminim në shoqëri, përmirësimin e jetës dhe pasojave që janë shkaktuar nga përdorimi i drogave.

Në këtë mënyrë do të zbutën apo zvogëlohen pasojat (varfëria, papunësia, prostitucioni, kriminaliteti dhe sëmundjet eventuale).

### **6.1.4 Zvogëlimi dëmit**

Programet për reduktimin e kërkesës dhe pasojat e dëmshme paraqesin një sër veprimesh dhe aktiviteteve që duhet të ndërmerren për zvogëlimin e pasojave shëndetësore, sociale të cilat

rrjedhin si shkak i keqpërdorimit me droga. Me zvogëlim të dëmeve arrihet efikasitet edhe në parandalimin e shkakimit të pasojave tjera sociale, shëndetësore, kriminale etj dhe mbrojtjen nga to. Me mbajtjen nën kontroll të vazhdueshëm të dukurisë së drogave dhe personave të varur nga droga arrihet të stabilizohet gjendja duke parandaluar përhapjen e sëmundjeve ngjitëse jo vetëm në mesin e përdoruesve të drogave,por edhe më gjerë. Arrihet të ulet niveli i krimit në të gjitha nivelet

### **6.1.5 Bashkëpunimi në reduktimin e kërkesës**

Për të zvogëluar kërkesën dhe për të zvogëluar dëmet nga përdorimi apo keqpërdorimi i drogave nevojitet angazhim i të gjitha strukturave duke filluar që nga institucionet publike në të gjitha nivelet lokale dhe qendrore, komuniteti dhe shoqëria civile deri tek individët. Veprimet e këtij objekti duhet të jenë të koordinuara dhe të orientuara asisoj që të ketë gjithë përfshirje duke ndërmarr masa për sensibilizimin e opinionit të gjerë, identifikimin e hershëm të prezencës së drogave dhe përdorimit,masa të duhura të trajtimit,rehabilitimit si dhe tentativat maksimale për risocializim dhe ri-integrim në drejtim të zvogëlimit të dëmeve. Këto masa përfshijnë edhe veprimet në zbulimin e hershëm që nënkupton marrjen e masave, stimulimin dhe motivimin e personave që kanë filluar të përdorin drogën, të ndërpresin këtë në mënyrë që të mund të fillohet me trajtimin e tyre (shërimin).

Çdo masë për zbulimin e hershëm të përdoruesëve të drogës parandalon dëmtimin e mëtejme të shëndetit të tyre sidomos të ndërlidhura me sëmundje ngjitëse si: Hepatiti B , C dhe HIV infeksioni.

## **6.2 Reduktimi i Ofertës dhe Furnizimit**

Reduktimi i ofertës së drogave përfshinë masat e përshtatshme të ndërmarra për pengimin e kultivimit të bimëve prej të cilave përfitohet droga dhe kufizimin e prodhimit të tregtimit dhe shpërndarjes së barnave narkotike substancave psikotrope (narkotikët) dhe prokurorëve, parandalimin e krimit të organizuar me drogë dhe pastrimit të parave të fituara përmes tregtisë me droga dhe prekursorë.

Me qëllim të zvogëlimit të ofertës për droga duhet të ndërmerren një seri aktivitete të ndryshme nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e ligjit.

Problematika e ofertës me drogë në Republikën e Kosovës nuk është e izoluar, por një aktivitet i tillë varet nga gjendja momentale e tregtisë së paligjshme në aspektin vendor dhe ndërkombëtar.

Që të arrihet sukses në zbatimin e masave për zvogëlimin e ofertës së drogës dhe shkatërrimin e grupeve të organizuara kriminale me droga dhe prekursor është e nevojshme një angazhim, koordinim dhe bashkëpunim i organeve të zbatimit të ligjit në kuadër të Ministrive përkatëse dhe prokurorive përkatëse.

Policia e Kosovës dhe Prokuroria e mbështetur edhe nga agjencitë tjera të zbatimit të ligjit luan rol kyç në fushën e parandalimit të kriminalitetit me droga dhe prekursorë duke ndërmarrë një sërë aktivitete për zbulimin e veprave penale që lidhen me drogë dhe shkatërrimin e grupeve kriminale duke përfshirë arrestimin e personave të dyshuar, konfiskimin e drogave dhe prekursorëve, konfiskimin e të gjitha sendeve tjera të paligjshme.

MPB do të mbështes të gjitha agjencitë e zbatimit të ligjit dhe prokuroritë për të ndërmarrë masa të kontrollimit dhe përgjegjësisë për personat dhe ndërmarrjet që merren me tregti të brendshme dhe të jashtme të medikamenteve dhe prodhimit të tyre që lidhet me kriminalitetin e drogave dhe prekursorëve, bashkëpunimi me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave , Administratën Tatimore, Agjencionin Kosovar për Produkte Medicinale, Doganën e Kosovës për kontrollimin e aktiviteteve të tyre në lidhje me pasurinë e fituar përmes kriminalitetit me droga me qëllim që të thyhen kanalet e kriminalitetit të brendshëm dhe ndërkombëtar.

Mbikëqyrja efikase e qarkullimit të prekursorëve të cilët shpesh përdoren në prodhimin ilegal të drogave është element kyç për ta zvogëluar prodhimin (përpunimin ) e drogave ilegale.

Është e nevojshme vendosja e kontrollit të shtuar të qarkullimit të prekursorëve në tregun e brendshëm dhe të jashtëm si dhe ngritja e vetëdijes për problemet që shkakton keqpërdorimi i prekursorëve.

### **Objektivat për Reduktimin e Ofertës janë:**

6.2.1 Parandalimi i furnizimit dhe ofertës

6.2.2 Mbikëqyrja e Barnave Narkotike, Substancave Psikotrope dhe Prekursorëve

6.2.3 Hetimet (zbulimi) dhe ndjekja

6.2.4 Ndëshkimet (dënimet)

6.2.5 Bashkëpunimi në Reduktimin e Ofertës dhe Furnizimit

#### **6.2.1 Parandalimi i Furnizimit dhe Ofertës**

Parandalimi në Furnizimin me drogë përfshinë marrjen e një sërë masash dhe veprimesh nga agjencitë e zbatimit të ligjit në fushën e sigurisë të cilat kanë për qëllim kapjen dhe konfiskimin e drogave para se të dalin në qarkullim për shitje dhe shpërndarje. Këto masa dhe veprime ndërmerren në koordinim nga agjencitë e zbatimit të ligjit, agjencionet e përfshira në MIK, PK-ja, Dogana në bazë të informacioneve të mbledhura dhe të analizuara mirë dhe përfshijnë veprimet e planifikuara në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Veprimet ndërmerren me qëllim parandalimin e kultivimit, prodhimit, posedimi, shpërndarjes, shitjes, përdorimit, kalimit nëpër territorin tonë duke siguruar një ambient të qetë dhe të sigurt për popullatën dhe institucionet shtetërore. Këto veprime janë të obligueshme për të gjitha agjencitë e zbatimit të ligjit nën koordinimin dhe udhëheqjen e Policisë së Kosovës si institucion përgjegjës për hetimin e veprave penale që lidhën me drogë dhe këto veprime mbikëqyren nga Prokuroria e Shtetit. Masat që ndërmerren nën udhëheqjen e Policisë së Kosovës dhe në koordinim me agjencitë tjera përfshijnë veprime kontrolluese dhe monitorime permanente të kufirit me të gjitha shtetet fqinjë, lokacionet e dyshuara për kultivim apo shpërndarje në tërë territorin, lokacionet për përdorim (laboratorët klandestine), keqpërdorim të drogave, kontrollimin e keqpërdorimit të barnave narkotike etj. Në këto veprime përfshihen edhe shkëmbimi i informacioneve nga të gjithë faktorët në drejtim të grumbullimit në Policinë e Kosovës për analizim dhe veprim konkret, në pajtim me vendimin e Qeverisë për themelimin e mekanizmave për bashkëpunim ndërkombëtar, me Strategjinë Nacionale për Parandalim të Krimin dhe Policia e Udhëhequr nga Inteligjenca.

### **6.2.2 Mbikëqyrja e Barnave Narkotike, Psikotropike dhe Prekursorëve**

Mbikëqyrja e prodhimit, importimit, eksportimit, transitit, deponimit, distribuimit dhe dispenzimit të barnave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve duhet të bëhet nga agjencitë përkatëse. Policia e Kosovës së bashku me Inspektoratin e Farmacisë do të ndërmarrin veprime me qëllim kontrollimin e qarkullimit të barnave narkotike. Me anë të mbikëqyrjes do të parandalohen keqpërdorimet e barnave narkotike. Inspektorati i Farmacisë bën kontrolle të kohe pas kohëshme lidhur me shpërndarjen dhe përshkrimin e recetave për barnat narkotike në raport me planifikimin vjetor të nevojave për narkotikë dhe prekursorë.

### **6.2.3 Hetimet (zbulimi) dhe Ndjekja**

Hetimet janë veprime procedurale penale që ndërmerren nga policia nën mbikëqyrjen e Prokurorit Publik në drejtim të zbulimit të veprave penale që ndërlidhen me drogat, mbledhjes



dhe sigurimit të provave dhe dëshmime, arrestimin e personave të dyshuar, konfiskimin e sendeve të paligjshme me qëllim të lehtësimit apo mbarëvajtjes së procedurës penale.

Hetimet lidhur me veprat e drogave përfshijnë të gjitha nivelet e kryerjes së vepës penale: kultivimin, prodhimin, posedimin, trafikimin, shpërndarjen, shitjen dhe financimin qofshin këto veprime individuale apo grupe të formave të krimit, të organizuar në nivel lokal, vendor apo rajonal e ndërkombëtar.

Veprimet hetimore duhet të jenë të koordinuara mirë dhe të centralizuara në njësitet përgjegjëse me qëllim të racionalizimit të kohës, shpenzimeve operativo-hetimore dhe veprimeve tjera administrative si dhe eliminimit të dyfishimit të hetimeve si brenda territorit të Republikës së Kosovës po ashtu edhe ato që ndërlidhen me shtetet tjera në aspekt ndërkombëtar e që mund të kenë ndërlidhje kriminale me vendin apo qytetet tonë.

Në veprimet parapenale Policia bashkëpunon me agjencionet tjera si: AKI, DOGANAT dhe Inspektoratin e AKPM-së .

#### **6.2.4 Ndëshkimet (dënimet)**

Ashpërsimin e politikës ndëshkimore si dhe konfiskimin e pasurisë së fituar nga tregtia me drogë.

Do të synohet që përmes ndëshkimeve të kryerësve të veprave penale të trafikimit me narkotik të arrihet zvogëlimi i kërkesës dhe ofertës.

Do të konfiskohet pasuria e fituar më anë të veprës penale të trafikimit me narkotikë si dhe nga i dënuari do ti kompensohet dëmi i shkaktuar agjencive për zbatim të ligjit gjatë zhvillimit të procedurës penale

#### **6.2.5 Bashkëpunimi në Reduktimin e Ofertës dhe Furnizimit**

Ngritjen e nivelit të bashkëpunimit dhe koordinimit në mes të institucioneve të zbatimit të ligjit dhe aktereve tjera me mandat në fushën e narkotikëve, në luftimin e aktiviteteve jo ligjore me qëllim të zvogëlimit të ofertës dhe furnizimit.

Ngritjen e bashkëpunimit në mes të institucioneve të zbatimit të ligjit me shoqërinë civile dhe krijimi i besimit të ndërsjellë.

Zhvillimin e bashkëpunimit me Agjencionin Kosovar të Inteligjencës .

Ngritjen e nivelit të bashkëpunimit ndërkombëtar me Shtetet dhe Organizatat Ndërkombëtare.

Të ketë aktivitet tek ngritja e kapaciteteve.

### **6.3 Bashkëpunimi dhe Koordinimi**

Bashkëpunimi dhe koordinimi i aktiviteteve të të gjitha institucioneve në nivelin lokal, qendror dhe ndërkombëtar është kusht për një punë efikase të veprimeve të koordinuara me synim parandalimin, trajtimin, hetimin, zbulimin dhe luftimin e drogave.

Bashkëpunimi dhe koordinimi i aktiviteteve përfshinë marrjen e një sërë veprimesh, masash të cilat kanë për qëllim ndërlidhjen institucionale në mes të gjithë akterëve institucional për të zbatuar këtë strategji, objektivat dhe aktivitetet.

6.3.1 Bashkëpunimi dhe Koordinimi Ndërinstitucional

6.3.2 Bashkëpunimi dhe Koordinimi ndërkombëtar

6.3.3 Avancimi i Mëtejme i Kornizës Ligjore

#### **6.3.1 Bashkëpunimi dhe Koordinimi Ndërinstitucional**

Harmonizimin e aktiviteteve me qëllim të bashkëpunimit dhe koordinimit në mes të institucioneve të zbatimit të ligjit për identifikimin me kohë të keqpërdoruesve dhe formave të keqpërdorimit të drogave dhe prekursorëve. Ndërtimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, në shkëmbim të informatave. Bashkëpunimi dhe koordinimi në mes të Policisë, Doganës, Prokurorisë dhe Gjykatave me qëllim të ndjekjes dhe ndëshkimit të keqpërdoruesve të drogave dhe prekurësoreve. Bashkëpunimi dhe koordinimi i aktiviteteve mes institucioneve me qëllim të prishjes së aktiviteteve të individëve dhe grupeve kriminale që keqpërdorin droga dhe prekursorë. Ngritja e bashkëpunimit bilateral dhe multilateral për të përforcuar përpjekjet për shkëmbimin e intelgjencës me qëllim të pengimit apo shkatërrimit të aktiviteteve të keqpërdoruesve të drogave. Harmonizimi i aktiviteteve me qëllim të Bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve mes institucioneve të zbatimit të ligjit për identifikimin me kohë të keqpërdoruesve dhe formave të keqpërdorimit të drogave dhe prekursorëve. Grumbullimi efikas dhe me kohë i informacioneve si dhe analizimi i tyre për individët dhe grupet e mundshme që keqpërdorin drogat dhe prekursorët. Institucionet përkatëse duhet ti harmonizojnë aktivitetet në nivelin qendror dhe lokal si dhe në aspektin horizontal dhe vertikal me qëllim të kontrollit të prodhimit, furnizimit, ofertës, përpunimit qarkullimit jo ligjor me droga dhe prekursorë. Ndërtimi i bashkëpunimit ndërinstitucional në shkëmbimin e informatave. Të gjithë akterët duhet të marrin pjesë aktive në bashkëpunimin ndërinstitucional në shkëmbimin e informatave me qëllim të koordinimit të aktiviteteve për parandalim dhe zvogëlim të ofertës dhe kërkesës

për droga.

### **6.3.2 Bashkëpunimi dhe Koordinimi Ndërkombëtar**

Prodhimi, qarkullimi dhe përdorimi i drogave ka karakter ndërkombëtar dhe nevojitet bashkëpunim i institucioneve dhe organizatave në aspektin rajonal dhe global në nivel partneriteti.

Në këtë perspektivë krijohen kushtet për përpjekjet ndërkombëtare në luftimin e drogës, bashkëpunimin me institucionet evropiane si dhe integrim sa më të shpejtë në Bashkimin Evropian.

Është i nevojshëm bashkëpunimi dhe bashkëveprimi në mes institucioneve të Kosovës dhe institucioneve tjera ndërkombëtare që merren me luftën dhe trajtimin e kësaj dukurie.

Ngritja e bashkëpunimit bilateral dhe multilateral për të përforcuar përpjekjet për shkëmbimin e inteligjencës me qëllim të pengimit apo shkatërrimit të aktiviteteve të keqpërdoruesve të drogave.

Institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës duhet t'i intensifikojnë përpjekjet për bashkëpunim ndërkombëtar me qëllim të shkëmbimit të inteligjencës për të penguar dhe shkatërruar aktivitetet e individëve dhe grupeve kriminale që keqpërdorin drogat.

Intensifikimi i bashkëpunimit ndërkombëtar duhet të mbështetet edhe në përpjekjet e Institucioneve të Republikës së Kosovës për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare relevante për luftim kundër drogave.

### **6.3.3 Avancimi i Mëtejme i Kornizës Ligjore**

Korniza ligjore është akteri primar që ndikon në parandalimin dhe luftimin e drogave përmes mekanizmave përgjegjës. Problemi i drogave dhe infrastruktura ligjore është çështje e veçantë që kërkon përkushtim, angazhim dhe trajtim të menjëhershëm dhe shumë serioz nga të gjitha institucionet që merren me zbatimin e rendit dhe ligjit në Kosovë. Në kuadër të kësaj avancimi dhe harmonizimi i kornizës ligjore: Amandamentimi i Kodit dhe Procedures Penale (në proces), amandamentimi dhe harmonizimi i Ligjit për barna narkotike, substanca psikotrope dhe prekursorë e sidomos rishikimi dhe freskimi i listave dhe tabelave të këtij ligji (02/L-128) dhe ligjeve tjera që ndërlidhen me Droga do të ndikojë drejtpërdrejt në parandalimin dhe luftimin e drogave dhe dukurive tjera që ndërlidhen me drogat.

## **6.4 Mekanizmat Mbështetës dhe Hulumtues**

Roli i mekanizmave mbështetës dhe hulumtues kur kemi të bëjmë me dukurinë e përdorimit, zbulimit dhe konfiskimit të substancave narkotike është i një rëndësie të veçantë. Mekanizmat mbështes si Qendrat Emergjente, Instituti i Mjekësisë Ligjore, Laboratori i Forenzikës, AKPM, Instituti i Shëndetit publik mbështesin organet tjera të zbatimit të ligjit në realizimin e objektivave të tyre ( Policisë, Prokurorisë dhe Gjykatave).

6.4.1 Instituti i Mjekësisë Ligjore

6.4.2 Agjencia e Kosovës për Forenzikë

6.4.3 Laboratori i AKPM-së

6.4.4 Hulumtimet

6.4.5 Observatori Nacional për Droga

### **6.4.1 Instituti i Mjekësisë Ligjore**

Instituti i Mjekësisë Ligjore e bënë ekzaminimin dhe ekspertizën e personave të cilët dyshohet se kanë vdekur nga mbidoza dhe përdorimi i prekusoreve ( substancave kimike të përziera). Pas ekzaminimit një kopje e raportit të ekspertizës i dërgohet Koordinatorit Nacional në mënyrë që ai të jë i informuar për numrin e vdekjeve të shkaktuara nga shkakut i përdorimit të substancave narkotike.

### **6.4.2 Agjencia e Kosovës për Forenzikë**

Laboratori i Forenzikës ka filluar të funksionoj si institucion në kuadër të Policisë pothuaj qysh prej fillimit të funksionimit të Policisë së Kosovës si institucion. në kuadër të Laboratorit të Forenzikës që nga viti 2004 ka filluar punën sektori i Drogave (sektori për identifikimin e narkotikëve të rrezikshëm, substancave psikotrope dhe prekursorëve). Ky sektor është themeluar në kuadër të Laboratorit të Forenzikës me qëllim të kryerjes së analizave kimike të të gjitha substancave të dyshuara për droga që vijnë nga vendi i ngjarjes dhe që janë objekt i procedurës penale. Tani me qëllim të rritjes së efikasitetit, bashkëpunimit dhe koordinimit më të mirë ndër institucional Sektorit të Drogave gjegjësisht Agjencia e Kosovës për Forenzikë ( e themeluar me Ligj) ka kaluar në kuadër të MPB-së dhe ofron shërbime mbështetëse për të gjitha institucionet dhe Agjencitë që janë në shërbim të zbatimit të rendit dhe ligjit në Kosovë.

MPB përmes AKF-së gjegjësisht Sektorit të Drogave do të bashkëpunoj dhe mbështes të gjitha institucionet dhe agjencitë e zbatimit të ligjit të cilave u hyn në punë identifikimi i narkotikëve të rrezikshëm substancave psikotrope dhe prekursorëve të shpallur si të rrezikshëm përmes

legjislacionit të aplikueshëm në territorin e Republikës së Kosovës me qëllim të uljes së kontrabandës dhe kriminalitetit të drogave substancave psikotrope dhe prekursorëve duke përfshirë: prodhimin, qarkullimin, përdorimin dhe përpunimin e drogave në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, Agjencionin Kosovar për Produkte Medicinale, Doganën e Kosovës dhe Institutin e Mjekësisë Ligjore.

**Laboratori i Forenzikës** e bënë analizimin dhe identifikimin e Drogave (Analizat Kualitative), zhvillimi i metodave për analiza kuantitative të drogave dhe me rezultatet e tilla njofton autoritetet përkatëse (PK, Prokuroritë, Gjykata). Hulumton lidhur me drogat e reja të identifikuar dhe i njofton organet përkatëse.

#### **6.4.4 Laboratori i AKPM-së**

Laboratori i AKPM-së bënë identifikimin e mostrave reprezentative të bimëve, barnave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve. Po ashtu bënë edhe kontrollin e kualitetit të barnave narkotike. Bënë identifikimin e substancave të dyshuara si narkotik të cilat mund të keqpërdoren si barna narkotike. Njofton policinë dhe inspektoratin farmaceutik lidhur me narkotiket e rinj të identifikuar.

#### **6.4.5 Hulumtimet**

Të gjitha institucionet e interesuara, si publike ashtu edhe OJQ-të mund të bëjnë hulumtime lidhur me dukuritë e drogave pas marrjes së autorizimit dhe pas përfundimit të hulumtimit janë të obliguara që ta informojnë koordinatorin Nacional lidhur me rezultatet e hulumtimit. Hulumtimet janë të rëndësishme për zbulimin e trendeve, dukurive dhe nevojave për angazhimin e të gjitha institucioneve përgjegjëse të parapara me strategji nacionale. Hulumtimet profesionale e lehtësojnë realizimin e objektivave dhe aktiviteteve të parapara me planin e veprimit. Mirëpo që të arrihet kjo, hulumtimet duhet të jenë profesionale, serioze dhe reale duke i përfillur standardet e parapara për hulumtim.

#### **6.4.6 Observatori Nacional për Droga**

Observatori nacional për droga është mekanizëm i cili e bënë monitorimin e dukurive që kanë të bëjnë me drogat si: trendet, parandalimin, trajtimin dhe rehabilitimin, hulumtimin, identifikimin e llojeve të reja të drogave, etj për të cilat raporton te Koordinatori Nacional dhe në EMCDDA (Observatori i drogave është institucion nën varësinë e Koordinatorit Nacional i cili në mënyrë të pavarur bashkëpunon dhe bashkërendon me institucionet tjera lidhur me dukurinë e drogave në RKS.

Përpilon raporte vjetore sipas kërkesave të EMCDDA dhe Koordinatorit Nacional. Raporton tek Koordinatori Nacional në bazë të raporteve të pranuar për drogat.

## **6.5 Mbikëqyrja dhe Monitorimi**

Që aktivitetet e parapara me Planin e Veprimit të realizohen në mënyrë sa më efektive dhe efikase duhet të egzistoj komisioni mbikqyrës ndërinstitucional i nivelit më të lart i cili e bënë mbikqyrjen e realizimit të objektivave dhe aktiviteteve.

### **6.5.1 Mbikëqyrja e Zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit**

Mbikëqyrja e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të veprimit bëhet nga Komisioni Mbikqyrës ndërinstitucional i cili përcjell realizimin e aktiviteteve të parapara me Planin e Veprimit.

### **6.5.2 Monitorimi Periodik i Zbatimit të Aktiviteteve**

Monitorimi periodik i zbatimit të aktiviteteve nga Komisioni Mbikqyrës bëhet në bazë vjetore.

### **6.5.3 Evaluimi**

Evaluimi i realizimit të Planit të Veprimit do të behet nga një punëtori e përbashkët e akterëve të përfshirë e cila do të organizohet nga Koordinatori Nacional.

### **6.5.4 Komisioni për Vlerësimin e Strategjisë**

Komisioni për vlerësimin e Strategjisë formohet nga Koordinatori Nacional. Ky komision do të Raportoje me shkrim te koordinatori Nacional.

#### **a. Roli i Sistemit të Monitorimit**

Procesi i zbatimit të strategjisë, do të jetë një proces i realizimit të objektivave strategjike, objektivave specifike si dhe aktiviteteve. Monitorimi dhe vlerësimi i realizimit të objektivave dhe efektshmërisë së aktiviteteve përkatëse, janë pjesë integrale e strategjisë dhe komponentë kryesore e procesit të zbatimit të saj. Monitorimi dhe vlerësimi do të shërbejë për të ndjekur ecurinë e strategjisë, për të matur në proces shkallën e realizimit të objektivave të saj, për të vlerësuar nevojën dhe përcaktuar drejtimet e rregullimeve, veçanërisht lidhur me aktivitetet.

Procesi i monitorimit do të realizohet nga institucionet përgjegjëse me pjesëmarrjen e gjerë të grupeve të interesuara.

Dimensionet kryesore të monitorimit dhe vlerësimit të strategjisë janë:

- Kapacitetet institucionale;

- Treguesit e monitorimit përgjatë dhe në fund të periudhës tri vjeçare;
- Burimet e informacionit dhe instrumentet matëse;
- Shpërndarja dhe përdorimi i rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit

#### **b. Kapacitetet Institucionale për Monitorim dhe Vlerësim**

Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit, do të shtrihet në të gjitha institucionet bartëse dhe përgjegjëse për realizimin e objektivave të përcaktuara në Strategjinë dhe Planin e Veprimit.

- Ministria e Punëve të Brendshme, si bartëse dhe përgjegjëse kryesore për realizimin e objektivave, do të krijojë njësinë e monitorimit dhe vlerësimit të strategjisë në vartësi të Koordinatorit Nacional kundër drogave.
- Kjo njësi do të monitorojë treguesit më të rëndësishëm që kanë të bëjnë me luftën kundër trafikimit me droga. Në fund të çdo viti, duhet të përgatisë një raport progresi mbi shkallën e realizimit të objektivave.
- Ministritë e linjës ( MD, MASHT, MEF, MSH, MPMS, MTL, MPB, MMPH, MKRS, MBZHR) do të përgjigjen për monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteteve që kanë si bartës këto ministri ose institucione në vartësi të tyre duke përfshirë edhe prokuroritë dhe gjykatat. Këto institucione do t'i raportojnë periodikisht Koordinatorit Nacional, në mënyrë që raportet të jenë të unifikuara.
- Organizatat jo-qeveritare, do të marrin pjesë në monitorimin dhe vlerësimin e strategjisë në tryeza të përbashkëta që do të organizohen nga Koordinatori. Në këto tryeza, shoqëria civile do të paraqesë raporte vëzhguese që lidhen me projektet dhe programet që ato kanë realizuar.
- Raportet të jenë të unifikuara.
- Organizatat jo-qeveritare, do të marrin pjesë në monitorimin dhe vlerësimin e strategjisë në tryeza të përbashkëta që do të organizohen nga Koordinatori. Në këto tryeza, shoqëria civile do të paraqesë raporte vëzhguese që lidhen me projektet dhe programet që ato kanë realizuar.

#### **c. Zgjedhja e Treguesve të Monitorimit dhe Vlerësimit**

Treguesit përfundimtarë

1. Numri i ligjeve dhe akteve nënligjore përkatëse, që kanë hyrë në fuqi pas miratimit të strategjisë;
2. Strukturat e krijuara ( Koordinator, Sekretariati)

3. Numri i marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe të nënshkruara me shtetet tjera;
4. Raportet e monitorimit dhe vlerësimit të strategjisë,
5. Përqindja e popullsisë së vetëdijesuar për çështjet e keqpërdorimit me droga
6. Numri i kurrikualve dhe teksteve shkollore që trajtojnë çështjet e keqpërdorimit të drogave
7. Numri i rasteve të trajtuara nga aspekti shëndetësor
8. Numri i projekteve dhe programeve për trajtim, ri-integrim dhe rehabilitim të përdoruesve të drogave.
9. Numri i rasteve të keqpërdorimit të drogave si dhe numri i përdoruesve të drogave
10. Sasia e drogës së konfiskuar, lloji dhe vlera.
11. Mesatarja e dënimeve dhe masave plotësuese të konfiskimit për kryerësit e krimit të keqpërdorimit të drogave
12. Numri i çështjeve të trajtuara nga Policia, Prokuroria dhe Gjykata.
13. Numri i aktiviteteve jashtë kurrikulare të zbatuara

**ç. Treguesit e Ndërmjetëm:**

Janë treguesit e monitorimit të aktiviteteve në Planin e Veprimit kundër drogave

**d. Instrumentet e monitorimit dhe vlerësimit**

1. Sistemi i standardizuar i mbledhjes dhe përpunimit të informacionit;
2. Të dhënat administrative, Statistike të MPB ( Policisë), MD, MSH, MEF ( Dogana, ATK), MASHT, Prokurorisë, Gjykatave, MPMS;
3. Mekanizmat kombëtarë, ndërkombëtarë referues;
4. Anketime dhe vrojtime të popullatës mbi shkallën e vetëdijesimit për çështjet kundër drogës.

**6.5.5 Informimi (Publikimi i Rezultateve të Monitorimit dhe Vlerësimit)**

Rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit do të shpërndahen për të bërë të njohur progresin në luftën kundër keqpërdorimit me droga, përkatësisht në arritjen e synimeve strategjike dhe objektivave specifike. Pasi të hartohen raportet e progresit, bazuar mbi të dhënat dhe vrojtimet, ato do të shpërndahen ndërmjet përdoruesve të cilët do të jenë:

1. Institucionet shtetërore qendrore dhe lokale
2. Partnerët ndërkombëtarë



3. Shoqëria civile
4. Media
5. Publiku i gjerë

Përgjegjës kryesor për shpërndarjen e rezultateve është Koordinatorin Nacional. Gjithashtu publikimi i rezultateve do të bëhet edhe nëpërmjet medias ose duke organizuar seminare dhe tryeza, për të nxjerrë konkluzione në lidhje me ecurinë e strategjisë duke angazhuar në mënyrë të veçantë shoqërinë civile.

Plani i Veprimit hartohet brenda kornizës së përgjithshme strategjike të përcaktuar në Strategjinë Kombëtare kundër drogave.

**Plani Veprues për Zbatimin e Kësaj Strategjie do të Përmbajë:**

- Objektivat e përgjithshëm;
- Objektivat specifike;
- Aktivitetet konkrete për realizimin e objektivave;
- Përcaktoj Institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për arritjen e secilit objektiv dhe aktivitet;
- Saktësoj kornizën kohore për realizimin e secilit objektiv;
- Përcakton burimet e nevojshme financiare për zhvillimin e aktiviteteve.
- Përcakton indikatorët apo treguesit për realizimin e secilit objektiv dhe aktivitet.

Plani veprues duhet të tregoj lidhshmëri me Kornizën e përgjithshme të Strategjisë kombëtare kundër drogave të Republikës së Kosovës.

